



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 gusht 2022
Nr. Ref.:AGJ 2033/22

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI19/21

Parashtrues

Sadik Pllana

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev.nr. 239/2019, të 26 nëntorit
2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sadik Pllana nga fshati Kçiq i Madh - Komuna e Mitrovicës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Sheremet Ademi nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr. 239/2019] të 26 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.276/17] e 13 qershorit 2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), dhe Aktgjykimin [C.nr.143/16] e 4 janarit 2017 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- dega në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

5. Më 18 janar 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), e të cilën kjo e fundit e pranoi më 21 janar 2021.
6. Më 25 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
7. Më 2 shkurt 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga përfaqësuesi: (i) dorëzimin e autorizimit që dëshmon se po e përfaqëson parashtruesin e kërkesës pranë Gjykatës; dhe (ii) plotësimin e formularit të kërkesës.
8. Më 15 shkurt 2021, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës autorizimin përkatës, dhe formularin e kërkesës.
9. Më 15 shkurt 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 71-2/21], gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 23 dhjetor 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, dosjen e plotë të lëndës.
14. Më 31 dhjetor 2021, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj dosjen e rastit.
15. Më 11 maj dhe 22 qershor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri kërkoi shtyrjen e rastit për plotësime shtesë.
16. Më 18 korrik 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata me shumicë konstatoi se (i) kërkesa e parashtruesit është e pranueshme; (ii) se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm; (iii) se nuk ka pasur shkelje tjetër të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; dhe, (iii) Aktgjykimi [Rev.nr.239/2019] i 26 nëntorit 2020 i Gjykatës Supreme të Kosovës, mbetet në fuqi.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 10 nëntor 1998, parashtruesi i kërkesës, sipas shkresave të lëndës, për shkak të një defekti në rrjetin e rrymës elektrike, dhe eksplodimit të një rezervuari, ka pësuar lëndime të rënda trupore. Ky aksident ka ndodhur në objektin e Shkollës Filllore “Enver Hadri” në Smrekonicë - Vushtrri.

Iniciimi i padisë në vitin 2000 e zhvilluar kundër Shkollës Filllore “Enver Hadri” në Smrekonicë të Vushtrrisë, dhe më pas kundër Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë

18. Më 2 nëntor 2000, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi për kompensim dëmi në Gjykatën Komunale. E paditur ishte Shkolla Filllore “Enver Hadri” në Smrekonicë - Vushtrri. Sipas shkresave të lëndës, padia pastaj është iniciuar ndaj një të paditurit tjetër, përkatësisht kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë.

19. Më 30 qershor 2003, Gjykata Komunale në Vushtrri, nxori Aktgjykimin [K.nr.143/2000] përmes së cilit: (i) aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) obligoi Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë që t'ia paguajë shumën përkatëse në emër të kompensimit të dëmit jo material. Një pjesë tjetër të kërkesëpadisë Gjykata Komunale e refuzoi si të pabazuar. Lidhur me kompensimin për dëmin jo-material, Gjykata Komunale u bazua në provat si: (i) ekspertiza e ekspertit të makinerisë; (ii) ekspertiza e neuropsikiatrit; dhe (iii) ekspertiza e kirurgut.
20. Më 11 korrik 2003, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë u ankua kundër vendimit të Gjykatës Komunale [K.nr.143/2000], në Gjykatën e Qarkut, duke theksuar se parashtruesi i kërkesës, nuk ka qenë asnjëherë i punësuar tek e paditura, dhe për më tepër ka qenë i paguar nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, sepse stafi administrativ është paguar nga kjo e fundit. Lidhur me këtë pikë, e paditura theksoi se Gjykata Komunale ka konstatuar në mënyrë të gabuar përgjegjësinë e saj.
21. Më 15 mars 2004, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, përmes Aktgjykimit [AC.nr.373/2003], aprovoi si të bazuar ankesën e ankuesit (Ministritë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë) dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [K.nr.143/2000], ashtu që tani, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet se Ministria e Arsimit “si resor i Qeverisë së Kosovës e Themeluar pas intervenimit të forcave të NATO-ës në Kosovë në vitin 1999, është përgjegjëse ndaj ish punëtorëve të arsimit para kohës së themelimit të kësaj ministrije, përkatësisht në rastin konkret edhe për kompensimin e dëmit shkaktuar paditësit më datë 10.11.1998, nga se nuk mund të bëhet fjalë për suksecion juridik të kësaj ministrije ashtu siç nuk ka pasur as në organet tjera shtetërore, ekzekutive de administrative të Kosovës, të themeluara nga UNMIK-u. Nuk ekziston asnjë bazë juridike, me të cilën parashikohet për kompenzim dëmi ndaj paditësit si ish punëtor në shkollë[...].”
22. Më 9 prill 2004, parashtruesi i kërkesës ushtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 1 dhe 2, pika 5 e 13 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e ish RSFJ nr.4/77) (në tekstin e mëtejshëm: LPK) “ku paditësi është lënduar në vendin e punës ku ka punuar pa ndërprere gjerë në momentin e lëndimit në vendin e punës”.
23. Më 25 janar 2005, Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktvendimit [Rev.nr. 97/ 2004], prish Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut AC.nr.373/2003 dhe hedhë poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të palejueshme. Gjykata Supreme, theksoi se bazuar në nenin 77 paragrafi 1 të LPK-së, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka legjitimitet procedural për të qenë palë e paditur.

Iniciimi i padisë së dytë në vitin 2006, e zhvilluar kundër Shkollës Fillore “Enver Hadri” në Smrekonicë të Vushtrrisë

24. Më 18 prill 2006, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padinë e dytë për kompensim dëmi, ndaj të paditurës Shkolla Fillore “Enver Hadri” në Smrekonicë - Vushtrri.
25. Më 3 maj 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri, mbajti seancë përgatitore me ç’rast vendosi përmes Aktvendimit se do mbahet seanca kryesore me 18 maj 2006. Në këtë seancë morën pjesë parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesi i Shkollës Fillore.
26. Më 18 maj 2006, përmes Aktvendimit u shty seanca kryesore në Gjykatën Komunale në Vushtrri, për 24 maj 2006.

27. Më 24 maj 2006, u mbajt seanca kryesore në Gjykatën Komunale në Vushtrri, ku morën pjesë parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesi i Shkollës Filllore, dhe avokati publik i Komunës. Parashtruesi i kërkesës, theksoi se mbetet pranë kërkesëpadisë së tij, ndërsa avokati i Komunës, mes tjerash, theksoi se padia është parashkruar.
28. Më 24 maj 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes Aktvendimit [C.nr.196/2006], e hedhë poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se çështja është e gjykuar, ashtu siç parashihet në nenin 333 të LPK-së. Gjykata Komunale, Aktvendimin AC.nr.373/2003 të Gjykatës së Qarkut dhe Aktvendimin [Rev.nr.97/2004] të Gjykatës Supreme, i konsideroi të plotëfuqishme.
29. Më 12 qershor 2006, parashtruesi i kërkesës parashtron ankesë në Gjykatën e Qarkut, dhe thekson: *“Mendoj se Gjykata ka marrë në tërësi mendimin e avokatit publik të komunës ku thotë se kjo është çështje e gjykuar[...]. Vërtetë është ashtu, por lënda ime nga personi juridik komunal në Vushtrri kur është mbajtur gjykimi i parë është vendosë me datë 30.06.2003, ka insistua dhe sipas tij është vepruar që lënda Padia: të merr drejtim të kundërt në MASHT e jo shkollës, ku ishte padia e drejtuar sepse ai e ka ditur që ai borxh i bie komunës. Del se ai gjykim është bërë në adresë të gabuar [...] Shihet se padia [padia e parë], iu ka drejtuar shkollës fillore “Enver Hadri” në Smrekonicë.[...] Me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë shihet se tërë procedura është zhvilluar në adresë të gabuar”.*
30. Më 14 mars 2013, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr.452/2012]: (i) miraton si të themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës; (ii) anulon aktvendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri C.nr. 196/2006 e 24 majit 2006, dhe çështjen ia kthen në ri-procedurë Gjykatës Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtrri. Gjykata e Apelit fillimisht theksoi se: (i) çështja kontestimore e evidentuar si C.nr.143/2000, paditës ishte Sadik Pllana [parashtruesi i kërkesës], dhe e paditur ishte Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë, por pala e paditur nuk ishte e njëjtë si në rastin C.nr. 196/06. Andaj, Gjykata e Apelit, theksoi se nuk janë krijuar kushtet ligjore për hedhjen e padisë si rast i gjykuar, sepse duhet të ekzistojë identiteti i objektit të kontestit në mes palëve të njëjta procedurale; (ii) shkelja procedurale konsiston në faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar a mund të jetë palë procedurale Shkolla Filllore “Enver Hadri” në Smrekonicë, për të cilën do duhej të kujdesej *ex officio*. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata e Apelit iu referua nenit 77 të LPK-së, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar faktin se i padituri, a disponon pasuri ndaj të cilit mund të zbatohet procedura e përmbarrimit; (iii) gjykata e shkallës së parë e ka pasur për detyrë që duke zbatuar nenin 83 të LPK-së, ta ftojë paditësin [parashtruesin e kërkesës], që ta rregullojë padinë ose të marrë masa të tjera në mënyrë që procedura të vazhdojë me personin që mund të jetë palë në procedurë.

Rigjykimi pas Aktvendimit CA.nr.452/2012 të 14 marsit 2013 i Gjykatës së Apelit, i zhvilluar kundër Komunës së Vushtrrisë

31. Më 23 maj 2013, sipas shkresave të lëndës është mbajtur një shqyrtim përgatitor në Gjykatën Themelore në Vushtrri dhe aty parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar: *“që e paditura Komuna e Vushtrrisë, SHF “Enver Hadri” në Fshatin Smrekonicë-Vushtrri, të obligohet që [parashtruesit të kërkesës], t’ia paguan në emër të kompensimit të dëmit [...]”.*
32. Më 4 shtator 2013, Gjykata Themelore lëshon Urdhëresë për pagesën e taksës gjyqësore. Në këtë shkresë e paditur figuronte Komuna e Vushtrrisë.
33. Më 4 shtator 2013, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [C.nr. 220/13], e hodhi poshtë si të pasafatshme padinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se

parashtruesit të kërkesës iu është shkaktuar dëmi me 10 nëntor 1998, dhe i njëjti me 30 nëntor 2000 ka ushtruar padi në gjykatën kompetente, dhe në fund me Aktvendimin Rev.nr.97/2004 të 25 janarit 2005, padia e parashtruesit të kërkesës është hedhë poshtë. Lidhur me afatet, Gjykata Themelore, iu referua nenit 376 (Kërkesa e shpërblimit të dëmit) të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 (në tekstin e mëtejshëm: LMD), sipas të cilit afati i parashkrimit është 3 vjet nga marrja në dijeni për shkaktimin e dëmit; dhe duke iu referuar këtij fakti, Gjykata Themelore konstatoi se dëmi i është shkaktuar parashtruesit të kërkesës më 11 nëntor 1998, dhe afati i parashkrimit është 10 nëntor 2003. Gjykata Themelore theksoi se bazuar në nenin 389 (Heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë) të LMD-së hedhja poshtë e padisë nuk shkakton ndërprerjen e afatit të parashkrimit, andaj konstatoi se parashtruesit të kërkesës afati i parashkrimit nuk i është ndalur për shkak hedhjes poshtë të padisë sipas aktvendimit të Gjykatës Supreme, por padia e re e parashtruesit të kërkesës e dorëzuar në vitin 2006, është e pasafatshme.

34. Më 23 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C.nr. 220/13], për shkak të: (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës theksoi se Gjykata Themelore, nuk i ka zbatuar sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë (Aktvendimit [CA.nr.452/2012] i 14 marsit 2013 i Gjykatës së Apelit), dhe *“pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të shkallës së dytë, pala paditëse ka vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të shkallës së dytë, dhe ka rregulluar padinë[...].”*
35. Më 18 mars 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac.nr.3017/13], aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar dhe anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore të 4 shtatorit 2013, dhe çështjen e ktheu në rigjykim tek kjo e fundit. Gjykata e Apelit, theksoi se nuk mund ta pranojë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sepse kjo e fundit ka bërë ngatërrimin e instituteve juridike ku në dispozitiv ka hedhë poshtë padinë si të pasafatshme ndërsa tërë arsyetimin e ka mbështetur në dispozitat e institutit të parashkrimit. Gjykata e Apelit më tej theksoi se bazuar në nenin 391 [Pa titull] të LPK-së, përkatësisht pikën f), është paraparë që padia është paraqitur pas afatit po që se me dispozita të veçanta është parashikuar afati për paraqitjen e saj, e që në rastin konkret, lidhur me padinë për kompensim dëmi, nuk janë paraqitur dispozita të veçanta. Gjykata e Apelit poashtu theksoi se nëse gjykata e shkallës së parë e trajton kërkesën e të paditurës se padia është paraqitur pas afatit duke u bazuar kështu në institucionin e parashkrimit, atëherë kjo çështje paraqet çështje materialo-juridike, për të cilën duhet të vendoset meritorisht.
36. Më 13 prill 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi “Urgjencë për përsheptim të procedurës” në Gjykatën Themelore, duke theksuar se e parashtron urgjencën për shkak të nevojës së domosdoshme për shërim mjekësor, për shkak të lëndimeve të pësuar. Parashtruesi i kërkesës theksoi se lënda ka përparësi sepse është në procedura që nga viti 2000.

Rigjykimi pas Aktvendimit C.nr. 220/13 i 18 marsit 2016 i Gjykatës së Apelit

37. Sipas shkresave të lënës, Gjykata Themelore kishte caktuar një seancë e cila më pas u shty për 12 korrik 2016, dhe në këtë fundit, përmes Aktvendimit u vendos që seanca për shqyrtim kryesor të caktohet për 5 gusht 2016.
38. Nga shkresat e lëndës me 31 tetor 2016, u mbajt seanca dhe me Aktvendim u vendos që (i) seanca shtyhet; dhe (ii) Gjykata Themelore në seancën e radhës do vendosë *“pas vendosjes paraprake për çështjen e parashkrimit të kërkesës”*.

39. Më 4 janar 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.143/16], refuzon padinë e parashtruesit të kërkesës për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit. Gjykata Themelore, theksoi se në çështjet e kompensimit të dëmit, sipas nenit 376 të LMD-së, afati i parashkrimit është 3 vjet nga marrja në dijeni për shkaktimin e dëmit, dhe 5 vjet nga dita e shkaktimit të dëmit. Dëmi i është shkaktuar parashtruesit të kërkesës më 10 nëntor 1998, dhe afati i parashkrimit është 10 nëntor 2003, sepse, kanë kaluar 5 vjet nga shkaktimi i dëmit. Gjykata Themelore theksoi se, bazuar në nenin 389 të LMD-së, hedhja poshtë e padisë nuk shkakton ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit, andaj, afati nuk është ndërprerë me faktin se i është hedhur poshtë padia me Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr. 97/2004]. Parashtruesit të kërkesës, duke parashtruar padinë e re në vitin 2006, sipas arsyeve më lart, ajo i është parashkruar.
40. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të se drejtës materiale, duke cekur se nuk ka kaluar afati i parashkrimit. Përgjigje në ankesë parashtrroi Komuna, e cila i mbështeti argumentet e saj në parashkrim sipas paragrafit 2 të nenit 389 të LMD-së.
41. Më 13 qershor 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 276/17], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C.nr.143/16]. Gjykata e Apelit theksoi se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm dhe: (i) nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase dispozitivi është i qartë dhe në harmoni me arsyet e aktgjykimit, dhe poashtu janë vërtetuar të gjitha faktet, mbi bazën e të cilëve është krijuar një pasqyrë e qartë, ku rrjedh se e drejta për kompensim dëmi është parashkruar; dhe (ii) nuk qëndrojnë pretendimet ankimore lidhur me zbatimin e gabuar të se drejtës materiale sepse bazuar në nenet 154, 371, 376, të LMD-së, e drejta e parashtruesit të kërkesës është parashkruar. Sa i përket pretendimit për ndërprerje të afatit të parashkrimit, për shkak të paraqitjes së padisë në vitin 2000, Gjykata e Apelit arsyetoi që bazuar në nenin 389 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-së, ku përcaktohen kushtet për ndërprerje të parashkrimit, në rastet kur hedhet padia nga ana e gjykatave, siç është rasti me Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev.nr. 97/2004 të 25 janarit 2005.
42. Më 16 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës parashtron revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar: (i) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse sipas tij, Aktgjykimi me të cilin refuzohet kërkesëpadia për shkak të parashkrimit, nuk është vendim procedural, por vendim që vendoset në mënyrë meritore; dhe (ii) zbatim të gabuar të se drejtës materiale, sepse sipas tij, bazuar paragrafin 3 të nenit 392 (Afati i parashkrimit në rastin e ndërprerjes) i LMD-së, është përcaktuar se kur parashkrimi është ndërprerë me ngritjen e padisë, ai fillon të rrjedhë nga dita kur kontesti të ketë marrë fund definitivisht. Andaj, parashtruesi i kërkesës në revizionin e tij konsideron se interpretimi i dispozitave të LMD-së, nga gjykatat e rregullta, duke mos pasur parasysh faktin se paraqitja e padisë ndërprente afatin e parashkrimit, paraqet pasiguri juridike, lidhur me realizimin e të drejtave të qytetarëve. Përgjigje në ankesë parashtrroi Komuna, e cila përsëri i mbështeti argumentet e saj në parashkrim.
43. Më 26 nëntor 2020, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Rev.nr. 239/2019], dhe refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit [Ac.nr. 276/17], të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme e pranoi si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, dhe theksoi se gjykata e shkallës së dytë, i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të rëndësishme për vendimmarrje. Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me të drejtën materiale, lidhur me institutin e parashkrimit, dhe çështjen e rrjedhjes së afatit, Gjykata Supreme

theksoi se për të njëjtat, gjykatat e instancave më të ulëta, kanë dhënë sqarime të plota të dispozitave ligjore, dhe Gjykata Supreme vlerëson se me nenin 389 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-së, përcaktohet qartë, se kur përfundon procedura me hedhjen e padisë siç është rasti me Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr. 97/2004], konsiderohet se kjo procedurë nuk ka shkaktuar ndërprerjen e afatit të parashkrimit. Gjykata Supreme, gjithashtu theksoi se në rastin konkret nuk mund të aplikohet as neni 390 paragrafi 1 i LMD-së dhe *“Paditësi pranon se Aktvendimin Rev.nr. 97/2004, të datës 25.01.2005, të Gjykatës Supreme të Kosovës, e ka pranuar me datë 22.04.2005, ndërsa padinë e re e ka ushtruar me datë 18.04.2006, pra pas afatit tre mujor, të përcaktuar sipas kësaj dispozite, andaj nuk mund të konsiderohet se kemi ndërprerje të parashkrimit sipas padisë së ushtruar me datë 3.11.2000.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

44. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar, përkatësisht Aktgjykimit të Gjykatës Supreme atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore siç garantohen me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; si dhe me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës.
45. Parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimet e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ankohet për afatin e parashkrimit, dhe për kohëzgjatjen e procedurës.
46. Së pari, sa i përket afatit të parashkrimit, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Sipas nenit 376 të LMD (1978) afati i parashkrimit është 3 vjet nga marrja në dijeni për shkaktimin e dëmit dhe 5 vite nga dita e shkaktimit të dëmit. Afati i parashkrimit për paditësin nuk është ndërprerë me vet faktin që të njëjtit i është hedhur poshtë padia sipas aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.97/2004”.*
47. Parashtruesi i kërkesës poashtu thekson se Gjykata Supreme: *“në arsyetimin e aktgjykimit, duke vërtetuar pretendimet dhe arsyetimet e gjykatave me të ulëta, ka konstatuar se padia e paditësit është parashkruar dhe deri te ky konstatim ka ardhur duke mos konsideruar se ka pasur ndërprerje të afatit të parashkrimit, me parashtrimin e mjeteve juridike të paditësit, fillimisht padinë e pare të dt. 02.11.2000 dhe padinë e datës 18.04.2006. Konsiderojmë se gjykatat me konstatimin e tillë nuk kane vendosur mbi themelësinë e kërkesë padisë, por me tepër janë lëshuar në afatet ligjore, të cilat për bindjen tonë, janë ndërprerë me paraqitjen, përkatësisht me ushtrimin e mjeteve juridike.”*
48. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se padia e dorëzuar me 2 nëntor 2000, pavarësisht a është hedhur poshtë me revizion, paraqet mjet juridik të paraqitur ndaj të paditurës, andaj, sipas LMD-së, me paraqitjen e mjetit juridik-paraqitjes së padisë, parashkrimi ndërpritet edhe me çdo veprim tjetër të ndërmarrë nga ana e kreditorit ndaj autoriteteve publike.
49. Parashtruesi i kërkesës thekson se pala e dëmtuar në procedurë duhet të dijë për dëmin që i është shkaktuar por *“[...]nuk mund të parashtrtoj padi pa e ditur edhe personin që i ka shkaktuar dëmin [...]të mësoj se cili është personi juridik fizik apo juridik që e ka shkaktuar dëmin”.*

50. Së dyti, sa i përket kohëzgjatjes së procedurave parashtruesi i kërkesës konsideron se: *“Mosefikasiteti i gjykatave dhe vonesat e shkaktuara pa fajin e parashtruesit të kërkesës në trajtimin me kohë të këtij rasti kanë shkaktuar pasoja të dëmshme për parashtruesin, i cili pas ngritjes së çështjes në Gjykata ka krijuar vartësi-litispedencë duke pamundësuar vazhdimin me kohë të procedurave ligjore dhe gjyqësore”. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, në shkresat e lëndës, në veçanti thekson se Gjykata e Apelit e mbanë lëndën shtatë (7) vjet (Aktvendimi CA.nr.452/2012 i 14 marsit 2013).*
51. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë kërkesës e pranueshme dhe: (i) të konstatojë se ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) të shpallë të pavlefshëm dhe ta kthej në rivendosje Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr. 239/2019 të 26 nëntorit 2020.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE I VITIT 1978

Neni 371

Afati i përgjithshëm i parashkrimit

“Kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.”

Neni 376
Kërkesa e shpërblimit të dëmit

*“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin.
Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi.
Kërkesa e shpërblimit të dëmit të krijuar nga cenimi i detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e këtij detyrimi.”*

Neni 389
Heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë

*“Ndërprerja e parashkrimit e bërë me ngritjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimin të kërkesës, konsiderohet se nuk ka filluar po qe se kreditori heq dorë nga padia ose veprimi që ka ndërmarrë.
Po kështu, konsiderohet se nuk ka patur ndërprerje në qoftë se padia e kreditorë ose kërkesa e tij hidhen poshtë apo refuzohen, ose në qoftë se anulohet masa e siguruar ose e ndërmarrë e ekzekutimit apo e sigurimit.”*

Neni 390
Hedhja poshtë e padisë për shkak të Inkompetencës

*“Në qoftë se padia kundër debitorit është hedhur poshtë për shkak të inkompetencës së gjykatës ose të ndonjë shkakut tjetër, që nuk përket esencës së çështjes, kështu që kreditori përsëri ngrit padinë brenda afatit prej tre muajsh nga data kur vendimi i hedhur poshtë e të padisë të ketë marrë formën e prerë, do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë.
E njëjta gjë vlen edhe për invokimin në mbrojtje, si dhe për theksimin e kompensimit të kërkesës në kontest, si dhe në rastin kur gjykata ose ndonjë organ tjetër e ka drejtuar debitorin që kërkesën e vet të do ta realizojë atë procedurën ndërgjyqësore.”*

Neni 392
Afati i parashkrimit në rastin e ndërprerjes

*“Pas ndërprerjes ose parashkrimit fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim.
Parashkrimi i ndërprerë me anë të pohimit nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pohimi.
Kur ndërprerja e parashkrimit ka filluar me ngritjen e padisë ose me invokimin në mbrojtje, ose duke theksuar kompensimin e kërkesave në kontest respektivisht me kallzimin e kërkesave në ndonjë proces tjetër parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri që nga dita kur kontesti të ketë marrë fund definitivisht ose të ketë mbaruar në ndonjë mënyrë tjetër.
Kur ndërprerja e parashkrimit të ketë lindur me kallzimin e kërkesës në procesin e falimentimit, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri që nga dita e përfundimit të këtij procesi.
E njëjta gjë vlen edhe kur ndërprerja e parashkrimit të ketë lindur me kërkesën e ekzekutimit të detyrueshëm ose të sigurimit.
Parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë.”*

LIGJI PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE i vitit 1977

Neni 77
[pa titull]

“[1]. Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik.

[2]. Me dispozitat e veçanta caktohet se kush, përpos personave fizikë dhe juridik, mund të jetë palë në procedurë.

[3]. Gjykata kontestimore, mundet, përjashtimisht, me efekt juridik në kontestin e caktuar, ta njohë cilësinë e palës edhe atyre formave të bashkimit që nuk kanë zotësinë e palës dhe atyre formave të bashkimit që nuk kanë zotësinë e palës në vështrim të dispozitave i paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni po se vërtetohet se, duke marrë parasysh objektin e kontestit, në esencë i përmbushin kushtet kryesore për kthimin e pasurisë së palës, e sidomos në qoftë se disponojnë asete shoqërore, respektivisht pasurinë mbi të cilën mund të zbatohet ekzekutimi. [...]”

Neni 83
[pa titull]

“[1]. Kur gjykata konstaton se personi që paraqitet si palë nuk mund të jetë palë në procedurë, kurse kjo e metë mund të evitohet, do të thotë paditësin që të bëjë ndreqje të nevojshme në padinë ose do të ndërmarrë masa tjera për të bërë që procedura të mund të vazhdohet me personin që mund të jetë palë në procedurë.”
[...]

Neni 333
Forma e prerë e aktgjykimit

“[1]. Aktgjykimi që nuk mund të kundërshtohet me ankim merr formën e prerë në qoftë se me të është vendosur mbi kërkesën e padisë ose kundër-padisë.

[2]. Gjykata gjatë gjithë procedurës kujdeset kryesisht nëse çështja është gjykuar në formë të prerë, e po qe se vërteton se kontestimi ka filluar mbi kërkesën rreth së cilës është marrë vendimi i formës së prerë, do ta hedhë poshtë padinë.

[3]. Në qoftë se në aktgjykim është vendosur mbi kërkesën që ka theksuar i padituri me kundërshtim për kompensim, vendimi mbi qenien ose mbi mosqenien e kësaj kërkeje merr formën e prerë.”

[...]

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 390
[pa titull]

Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta inicioj procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmerr masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji).

Neni 391
[pa titull]

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:

f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

52. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

53. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

54. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

55. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

56. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të

përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Procedurat e zhvilluara në periudhën 2 nëntor 2000 deri 25 janar 2005

57. Në tekstin e mëposhtëm, Gjykata-para se të vlerësojë meritat e rastit të parashtruesit të kërkesës-duhet si çështje paraprake të vlerësojë nëse procedurat e zhvilluara në periudhën 2 nëntor 2000 deri 25 janar 2005 bien në kuadër të juridiksionit kohor (*ratione temporis*) të Gjykatës.
58. Në lidhje me procedurat e zhvilluara në periudhën 2 nëntor 2000 deri 25 janar 2005, Gjykata rikujton se rasti ngërthen në vete një kontest të filluar me padinë e parë që nga 2 nëntori 2000. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet dispozitave të Rregullores së punës, përkatësisht rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) në të cilën përcaktohet që:

“(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(d) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën;”

59. Pas analizës së dosjes së lëndës konstatohet se padia e parë është nisur nga parashtruesi i kërkesës më 2 nëntor 2000 dhe procedurat rreth saj përfundojnë më 25 janar 2005, pra, datojnë nga periudha kohore para se të hyjë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës më 15 qershor 2008.
60. Prandaj, Gjykata nuk mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e akteve juridike për të cilat supozohet se kanë shkelur të drejtën e caktuar të garantuar me Kushtetutë sepse në atë kohë ato të drejta as nuk kanë qenë të përcaktuara e as të garantuara me Kushtetutë për faktin se as vet Kushtetuta nuk ka ekzistuar (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI170/18, parashtrues *Draško Šćekić*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 nëntorit 2019, paragrafi 37).
61. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se periudha e 2 nëntor 2000 deri më 25 janar 2005 është *ratione temporis* e papranueshme me Kushtetutën (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Blečić kundër Kroacisë*, nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 29 korrikut 2004). Në *Blečić kundër Kroacisë*, GJEDNJ e ka deklaruar të papranueshme kërkesën e përmendur për shkak se dispozitat e KEDNJ-së nuk i obligojnë vendet nënshkruese në lidhje me asnjë akt i cili është sjellë apo situatë ligjore e cila ka pushuar të ekzistojë para se KEDNJ-ja të hyjë në fuqi.
62. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet lidhur me këtë periudhë nuk janë *ratione temporis* të pranueshme me Kushtetutën dhe si të tilla duhet të shpallen të papranueshme bazuar në rregullin 39 (3) (d) të Rregullores së punës.

Meritat

I. Hyrje

63. Gjykata rikujton se esenca e rastit konkret, rrjedh nga lëndimi i rëndë trupor i parashtruesit të kërkesës, për shkak të një defekti në rrjetin e rrymës elektrike, në

vendin e tij të punës në objektin e Shkollës Filllore “Enver Hadri” në Smrekonicë – Vushtrri, më 10 nëntor 1998. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës fillimisht kishte parashtruar padi më 2 nëntor 2000 për kompensim dëmi në Gjykatën Komunale në Vushtrri, dhe më pas një padi më 18 prill 2006. Sa i përket padisë së parë, procedura përfundon me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr. 97/2004], përmes së cilës hedhet poshtë padija e parashtruesit të kërkesës sepse bazuar në nenin 77 paragrafin 1 të LPK-së, Ministria e Arsimit dhe Teknologjisë nuk e ka cilësinë e personit juridik, andaj nuk e ka aftësinë të jetë palë në procedurë.

64. Sa i përket padisë së dytë, Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes Aktvendimit hedhë poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se çështja është e gjykuar sipas nenit 332 të LPK-së, dhe më pas, Gjykata e Apelit anulon Aktvendimin e Gjykatës Komunale, dhe çështjen e kthen në riprocedurë në Gjykatën Themelore, duke theksuar mes tjerash se shkelja procedurale konsiston në faktin e gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar a mund të jetë palë procedurale Shkolla Filllore “Enver Hadri” në Smrekonicë, për të cilën do duhej të kujdesej *ex officio*. Gjykata Themelore në rigjykim, u bazua në afatin e parashkrimit duke u mbështetur në nenin 389 të LMD-së dhe duke theksuar se hedhja poshtë e padisë nuk shkakton ndërprerjen e afatit të parashkrimit. Pas paraqitjes së ankesës nga ana e parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit përsëri e kthen çështjen në rigjykim, duke theksuar se: (i) gjykata e shkallës së parë ka bërë ngatërrimin e instituteve juridike ku në dispozitiv e ka hedhë poshtë padinë si të pasafatshme ndërsa tërë arsyetimin e ka mbështetur në dispozitat e institutit të parashkrimit; dhe (ii) bazuar në nenin 391 të LPK-së, përkatësisht pikën f), është paraparë që padia është paraqitur pas afatit po që se me dispozita të veçanta është parashikuar afati për paraqitjen e saj, dhe që në rastin konkret, nuk ka dispozita të veçanta. Rrjedhimisht, në rigjykim, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit theksoi se: (i) sipas nenit 376 të LMD-së, afati i parashkrimit është 3 (tri) vjet nga marrja në dijeni për shkaktimin e dëmit, dhe 5 (pesë) vjet nga dita e shkaktimin të dëmit, e që për parashtruesin e kërkesës afati ishte 10 nëntor 2003; (ii) bazuar në nenin 389 të LMD-së, hedhja poshtë e padisë nuk shkakton ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit, andaj, afati nuk është ndërprerë me faktin se i është hedhur poshtë padia me Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr. 97/2004]. Në procedurën e ankesës, Gjykata e Apelit, arsyetoi duke u bazuar në nenin 389 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-së, ku përcaktohen kushtet për ndërprerje të parashkrimit. Në fund, në procedurën e revizionit, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr. 239/2019] poashtu u bazua në nenin 389 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-së, dhe theksoi se nuk mund të aplikohet neni 390 paragrafi 1 i LMD-së.
65. Esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, konsiston në pretendimin e tij se: (i) sipas nenit 376 të LMD-së afati i parashkrimit është 3 (tri) vjet nga marrja në dijeni për shkaktimin e dëmit dhe 5 (pesë) vjet nga dita e shkaktimin të dëmit. Sipas tij, afati i parashkrimit nuk është ndërprerë me vet faktin që të njëjtit i është hedhë poshtë padia sipas Aktvendimit [Rev.nr.97/2004] të Gjykatës Supreme; (ii) pala e dëmtuar në procedurë duhet të dijë për dëmin që i është shkaktuar por “*nuk mund të parashtroj padi pa e ditur edhe personin që i ka shkaktuar dëmin [...]të mësoj se cili është personi juridik fizik apo juridik që e ka shkaktuar dëmin*”. Parashtruesi i kërkesës mendon se nga kjo fillon të rrjedhë afati i parashkrimit; dhe (iii) mosefikasiteti i gjykatave dhe vonesat e shkaktuara pa fajin e tij në trajtimin me kohë të këtij rasti kanë shkaktuar pasoja të dëmshme për parashtruesin, i cili pas ngritjes së çështjes në gjykata ka krijuar vartësi-litispedencë duke pamundësuar vazhdimin me kohë të procedurave ligjore dhe gjyqësore.
66. Bazuar në specifikat e rastit konkret, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i

Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

67. Gjykata poashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, megjithatë të njëjtat nuk i arsyeton fare. Rrjedhimisht, Gjykata në vlerësimin e saj do fokusohet vetëm në pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket shkeljes të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
68. Gjykata në vijim, do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (1) të KEDNJ-së në dy aspekte: (i) përkitazi me çështjen e parashkrimit dhe palës që duhet paditur që ndërlidhet me interpretimin e ligjit nga gjykatat e rregullta; dhe (ii) përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

I. Vlerësim kushtetues përkitazi me pretendimin për interpretim të gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta për çështjen e parashkrimit të kërkesëpadisë

69. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, lidhur me pretendimet e tij për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm i ndërlidh me interpretimin e dhënë nga gjykatat e rregullta, lidhur me parashkrimin. Në esencë parashtruesi i kërkesës konsideron se: (i) afati i parashkrimit për të nuk është ndërprerë me vet faktin që të njëjtit i është hedhë poshtë padia sipas Aktvendimit [Rev.nr.97/2004] të 25 janarit 2005 të Gjykatës Supreme; (ii) ai nuk mund të parashtrtojë padi pa e ditur se cili është personi fizik apo juridik që e ka shkaktuar dëmin. Parashtruesi i kërkesës mendon se nga kjo fillon të rrjedhë afati i parashkrimit, çka në thelb, nënkupton se parashtruesi i kërkesës konteston interpretimin e ligjit nga gjykatat e rregullta lidhur me institutin e parashkrimit.
70. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ankohet për afatin e parashkrimit, duke theksuar se: (i) sipas nenit 376 të LMD-së afati i parashkrimit është 3 vjet nga marrja në dijeni për shkaktimin e dëmit dhe 5 vjet nga dita e shkaktimit të dëmit. Parashtruesi argumenton se afati i parashkrimit për të nuk është ndërprerë me vet faktin që të njëjtit i është hedhë poshtë padia sipas Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev.nr.97/2004]; dhe (ii) gjykatat nuk janë lëshuar në themelësinë e kërkesëpadisë por janë lëshuar vetëm në afatet kohore. Parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës poashtu ka theksuar se *“nuk mund të parashtrtoj padi pa e ditur edhe personin që i ka shkaktuar dëmin [...]të mësoj se cili është personi juridik fizik apo juridik që e ka shkaktuar dëmin”*. Parashtruesi i kërkesës mendon se nga kjo fillon të rrjedhë afati i parashkrimit.
71. Gjykata rikujton se inicimi i padisë së dytë ishte si rezultat i faktit që Gjykata Supreme kishte vendosur përmes Aktvendimit [Rev.nr. 97/ 2004], që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk e ka cilësinë e personit juridik, andaj nuk e ka aftësinë të jetë palë në procedurë. Në këtë linjë, parashtruesi i kërkesës, me 18 prill 2006 kishte parashtruar padinë e dytë, kundër Shkollës Filllore “Enver Hadri” në Smrekonicë të Vushtrrisë.
72. Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes Aktvendimit hedhë poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se çështja është e gjykuar sipas nenit 332 të LPK-së, dhe më pas, Gjykata e Apelit anulon Aktvendimin e Gjykatës Komunale, dhe çështjen e kthen në riprocedurë në Gjykatës Themelore, duke theksuar mes tjerash se

shkelja procedurale konsiston në faktin e gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar a mund të jetë palë procedurale Shkolla Fillore “Enver Hadri” në Smrekonicë, për të cilën do duhej të kujdesej *ex officio*. Gjkata Themelore në rigjykim e më pas edhe gjykatat e shkallëve më të larta, aplikojnë si bazë ligjore, dispozitat përkatëse të parashkrimit, dhe mbështeten kryesisht në nenin 389 të LMD-së ku përcaktohet se hedhja poshtë e padisë nuk shkakton ndërprerjen e afatit të parashkrimit. Sidoqoftë, Gjkata e Apelit, duke konsideruar se gjykata e shkallës së parë ka bërë ngatërrimin e instituteve juridike dhe faktin që bazuar në nenin 391 të LPK-së, përkatësisht pikën f), është paraparë që padia është paraqitur pas afatit po qe se me dispozita të veçanta është parashikuar afati për paraqitjen e saj, dhe që në rastin konkret, nuk ka dispozita të veçanta, vendosi që çështjen ta kthejë në rigjykim në Gjykatë Themelore.

73. Rrjedhimisht, Gjkata Themelore përmes Aktgjykimit përfundimisht u bazua në dispozitat për parashkrim dhe arsyetoi se: (i) sipas nenit 376 të LMD-së, afati i parashkrimit është 3 vjet nga marrja në dijeni për shkaktimin e dëmit, dhe 5 vjet nga dita e shkaktimit të dëmit, e që për parashtruesin e kërkesës afati ishte 10 nëntor 2003; (ii) bazuar në nenin 389 të LMD-së, hedhja poshtë e padisë nuk shkakton ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit, andaj, afati nuk është ndërprerë me faktin se i është hedhur poshtë padia me Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr. 97/2004]. Në procedurën e ankesës, Gjkata e Apelit, arsyetoi duke u bazuar paragrafin 1 dhe 2 të nenit 389 LMD-së, ku përcaktohen kushtet për ndërprerje të parashkrimit. Në fund, në procedurën e revizionit, Gjkata Supreme përmes Aktgjykimit poashtu u bazua në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 389 të LMD-së, dhe nuk mund të aplikohet neni 390 paragrafi 1 i LMD-së.

74. Gjkata Supreme në fund, në Aktgjykimin e saj [Rev.nr.239/2019] të 26 nëntorit 2020, kishte refuzuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, mes tjerash, duke arsyetuar si në vijim:

“Gjkata Supreme vlerëson se me nenin 389 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, është përcaktuar në mënyrë të qartë se në ato raste kur ka pasur ndonjë procedurë gjyqësore në mes të palëve, por procedura përfundon me hedhjen e padisë, siç ka ndodhur në rastin konkret me Aktvendimin Rev.nr.97/2004, Gjkata Supreme e Kosovës, padia e paditësit është hedhë poshtë, konsiderohet se kjo procedurë nuk ka shkaktuar ndërprerjen e afatit të parashkrimit, ndërsa duke marrë parasysh momentin e ndodhjes së rastit me datë 10.11.1998, dhe momentin kur padia është paraqitur në gjykatë me datë 18.04.2006, rezulton se padia është paraqitur pas afatit prej 5 viteve (parashkrimi absolut), gjegjësisht 7 vite, e 5 muaj, ndërsa afati absolut i parashkrimit sipas nenit 376.2 të LMD-së, (ligji i vjetër i cili ka qenë në fuqi kur ka ndodhur rasti). Po ashtu në rastin konkret nuk mund të aplikohet neni 390 paragrafi 1 i LMD-së, ku përcaktohet “Në qoftë se padia kundër debitorit është hedhur poshtë për shkak të in kompetencës së gjykatës ose të ndonjë shkakut tjetër, që nuk i përket esencës së çështjes, kështu që kreditori përsëri ngrit padinë brenda afatit prej tre muajsh nga data kur vendimi i hedhur poshtë e të padisë të ketë marrë formën e prerë, do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë. Paditësi pranon se Aktvendimin Rev.nr. 97/2004 të datës 25.01.2005, të Gjykatës Supreme të Kosovës, e ka pranuar me datë 22.04.2005, ndërsa padinë e re e ka ushtruar me datë 18.04.2006, pra edhe pas afatit tre mujor, të përcaktuar sipas kësaj dispozite, andaj nuk mund të konsiderohet se kemi ndërprerje të parashkrimit sipas padisë së ushtruar me datë 03.11.2000.”

75. Prandaj në esencë Gjkata vëren se Gjkata Supreme kur aplikoi nenin 389 të LMD-së i sqaroi parashtruesit të kërkesës se pse në rastin e tij ka parashkrim, duke theksuar se padia e parashtruesit të kërkesës u hodh poshtë me Aktvendimin [Rev.nr.97/2004] të 25 janarit 2005 të Gjykatës Supreme, dhe kjo nuk ka shkaktuar ndërprerjen e afatit.

Gjithashtu, duke u bazuar në momentin se kur ka ndodhur aksidenti, përkatësisht 11 nëntori 1998, dhe momentin kur është parashtruar padia e dytë në Gjykatë me 18 prill 2006, rezulton që kjo padi sipas paragrafit 2 të nenit 376 të LMD-së, është pas afatit prej 5 (pesë) viteve, pra ka ndodhur parashkrimi absolut, në afatin prej 7 (shtatë) vite e 5 (pesë) muaj. Gjykata Supreme poashtu kishte sqaruar se pse nuk aplikohet edhe paragrafi 1 i nenit 390 i LMD-së, duke theksuar se parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktvendimin [Rev.nr.97/2004] të 25 janarit 2005 me 22 prill 2005, ndërsa padinë e dytë (padinë e re) e kishte ushtruar pas afatit tre (3) muaj, ashtu siç kërkohet me dispozitën 390 të LMD-së. Rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet se ka ndërprerje të parashkrimit.

76. Në këtë linjë, Gjykata rikujton se paragrafi 1 i nenit 376 LMD përcakton se kërkesa për shpërblim dëmi parashkruhet për 3 (tri) vite nga dita kur i dëmtuar ka mësuar për dëmin, por kjo kërkesë parashkruhet për 5 (pesë) vite nga dita kur është krijuar dëmi.
77. Gjykata vëren se neni 389 i LMD-së, parasheh rastet e heqjes dorë, hedhjes poshtë ose refuzimit të padisë. Në këtë linjë, gjykatat e rregullta ishin bazuar në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 389 të LMD-së, ku paragrafi 1 specifikon se ndërprerja e parashkrimit e bërë me ngritjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër konsiderohet se nuk ka filluar po që se kreditori heqë dorë nga padia ose veprimi që ka ndërmarrë, ndërsa paragrafi 2 i nenit 389 i LPK-së thekson se nuk ka pasur ndërprerje të parashkrimit nëse padia e kreditorit hedhet poshtë apo refuzohet.
78. Gjithashtu, Gjykata Supreme kishte aplikuar edhe nenin 390 të LMD-së i cili në paragrafin 1 të tij thekson se nëse padia përkatëse është hedhur poshtë për shkak të inkompetencës së gjykatës ose të ndonjë shkakut tjetër, që nuk përket esencës së çështjes, kështu që kreditori përsëri ngrit padinë brenda afatit prej tre muajsh nga data kur vendimi i hedhur poshtë i padisë të ketë marrë formën e prerë, do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë.
79. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës sipas tri skenarëve ka humbur mundësinë e parashkrimit të padisë së tij, përkatësisht, (i) afateve prej 3 (tri) e 5 (pesë) viteve siç kërkohen me nenin 376 LMD-së për të bërë një kërkesë për dëmshpërblim, më pas, (ii) faktin që me Aktvendimin [Rev.nr.97/2004] të 25 janarit 2005 të Gjykatës Supreme atij iu është hedhur padia e tij dhe kjo ka rezultuar që mos të ndërprehet afati i parashkrimit ashtu siç parashihet me nenin 389 të LMD-së, dhe në fund (iii) fakti që nuk mund të aplikohet afati prej tre (3) muajsh siç kërkohet me paragrafi 1 i nenit 390 i LMD-së, sepse padinë e dytë parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur shumë muaj më vonë.
80. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së përkitazi me pretendimin për interpretim të gabuar të ligjit për institutin e parashkrimit nga gjykatat e rregullta.

II. Vlerësim kushtetues i pretendimit të parashtruesit të kërkesës rreth të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

81. Në trajtim të këtij pretendimi, Gjykata fillimisht rikujton edhe një herë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës i cili ndër të tjera thekson se *mosefikasiteti i gjykatave dhe vonesat e shkaktuara pa fajin e parashtruesit të kërkesës në trajtimin me kohë të këtij rasti kanë shkaktuar pasoja të dëmshme për parashtruesin, i cili pas ngritjes së çështjes në Gjykatë ka krijuar vartësi-litispedencë duke pamundësuar vazhdimin me kohë të procedurave ligjore dhe gjyqësore*. Gjykata rikujton se në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës në veçanti iu ishte referuar Aktvendimit [CA.nr.452/2012] të 14 marsit 2013 të Gjykatës së Apelit.

(i) Periudha që do të merret parasysh

82. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës së saj, ka vlerësuar se përlllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih rastet e GJEDNJ-së, *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës*, nr. 63235/00, Aktgjykim i 19 prillit 2007, paragrafi 65; *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, të 23 prillit 1987, paragrafi 64; shih gjithashtu rastin *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50, dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI127/15, parashtrues *Mile Vasović*, Aktvendim për papranueshmëri i 15 qershorit 2015, paragrafi 43; KI81/16, parashtrues *Valdet Nikqi*, Aktgjykim i 31 majit 2017; KI19/17, Aktvendim për papranueshmëri i 21 shkurtit 2018, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74; si dhe rastin e Gjykatës KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli"*, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 98). Prandaj, kërkesa për kohëzgjatje të arsyeshme, zbatohet për të gjitha fazat e procesit gjyqësor që synon zgjidhjen e kontestit, duke mos përjashtuar fazat pas gjykimit mbi meritat (shih rastin e GJEDNJ-së, *Robins kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22410/93 Aktgjykim i 23 shtatorit 1997, paragrafët 28-29).
83. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës siç u shpjegua më lart, kishte parashtruar padinë në vitin 2000, ndërsa padinë e dytë më 18 prill 2006. Parashtruesi i kërkesës sipas dosjes së lëndës, kishte kërkuar urgjencë më 13 prill 2016 në Gjykatën Themelore, duke theksuar se e parashtron urgjencën për shkak të nevojës së domosdoshme për shërim mjekësor, për shkak të lëndimeve të pësuar. Parashtruesi i kërkesës theksoi se lënda ka përparësi sepse është në procedura që nga viti 2000.
84. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, sipas paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, në rastin konkret llogaritet nga data e parashtrimi të padisë së dytë më 18 prill 2006 e deri në vendimin e fundit lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Aktgjykimi [Rev.nr. 239/2019] i 26 nëntorit 2020 i Gjykatës Supreme, në total prej 14 vite, 7 muaj dhe 8 ditë.

(ii) *Parimet relevante*

85. Gjykata para së gjithash thekson se, sipas praktikës konsistente të GJEDNJ-së, e cila është reflektuar edhe në praktikën e Gjykatës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përkatësisht: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e palëve në procedurë; (c) sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (ç) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon parashtruesi në kontest (shih rastet e GJEDNJ-së, *Mesić kundër Kroacisë*, nr. 19362/18, Aktgjykim i 5 majit 2022, paragrafi 127; *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 17766/19, Aktgjykim i 12 tetorit 2021, paragrafi 63; *Mishqjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010, paragrafi 44; *Gjonboçari dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 10508/02 Aktgjykim i 23 tetorit 2007, paragrafi 61; *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, nr.35382/97, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 38; *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 6 prillit 2000; *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43; *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128; *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 143; *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 209; shih, gjithashtu, rastet e

Gjykatës: KIo7/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2016, paragrafët 53-62; KI23/16, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2017, paragrafi 58; KI18/18, parashtrues *Isuf Musliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 qershorit 2018, paragrafi 43; KI13/19, parashtrues *Fevzi Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 qershorit 2019, paragrafët 65-72; KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli"*, Aktgjykim i 16 prillit 2019, paragrafët 96-106; KI104/20, parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2021, paragrafi 46; KI135/2020, me parashtruese *Hava Behxheti*, cituar më lart, paragrafët 39-54).

(iii) *Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës*

86. Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës ka rrjedhë si pasojë e një aksidenti në punë, në vitin 1998. Ai kishte parashtruar kërkesë për kompensim dëmi, për herë të parë në vitin 2000, ndërsa për herë të dytë në vitin 2006, duke kërkuar kompensim për lëndimet që ai ka pësuar, përfshirë zvogëlim të aftësisë punuese, dhimbjeve fizike dhe dhimbjeve shpirtërore.
87. Ashtu siç është elaboruar edhe më sipër, për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të marrë parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlikueshmëria e rastit; (b) sjellja e parashtruesit të kërkesës; (c) sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore; dhe (ç) rëndësia e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest.

(a) *Ndërlikueshmëria e rastit*

88. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës përmes të cilave ishte theksuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlikohet me çështje faktike dhe ligjore por gjithashtu mund të ndërlikohet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, *Famullia Greko-Katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150; *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, nr. 12539/86, Aktgjykim i 19 shtatorit 1994, paragrafi 55; *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63 dhe *Cipolleta kundër Italisë*, nr. 38259/09, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 44 ku edhe përkundër ndërlikueshmërisë së procedurave të falimentimit, GJEDNJ-ja kishte konstatuar se të njëjtat ishin zvarritur në kundërshtim me kriterin e gjyimit të drejtë "brenda një afati të arsyeshëm" siç garantohet me nenin 6 (1) të KEDNJ-së; po ashtu, shih rastet e Gjykatës, KI18/18, parashtrues *Isuf Musliu*, cituar më lart, paragrafi 45; dhe KI104/20, parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 48).
89. Në rastin konkret, Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës, u refuzua për shkak të parashkrimit. Pikënisja e padisë së parë të parashtruesit të kërkesës, dhe arsyetimet e gjykatave të rregullta në këtë periudhë, kanë ndikuar që në padinë e dytë të parashtruesit të kërkesës, të zbatohen dispozitat ligjore të parashkrimit. Ashtu siç u elaborua më lart në paragrafët 69-80, gjykatat e rregullta kishin aplikuar dispozitat e parashkrimit të cilit ishin të specifikuara konkretisht në LMD.
90. Në këto rrethana, Gjykata duke iu referuar edhe rrethanave faktike të rastit që ndërlikohen me vërtetimin e parashkrimit, gjen se rasti nuk ishte i ndërlikuar.

(b) *Sjellja e parashtruesit të kërkesës*

91. Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesave në parim kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat procedural të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë, parashtruesit e kërkesave duhet të kenë parasysh, gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tyre. Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve të kërkesave përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin, nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së, *McFarlane kundër Irlandës*, nr. 31333/06, Aktgjykim i 10 shtatorit 2010, paragrafi 148; *Eckle kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 82; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KIO7/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, cituar më lart, paragrafi 55).
92. Gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës vëren se parashtruesi i kërkesës më 13 prill 2016 kishte dërguar një "Urgjencë për përshpejtim të procedurës" në Gjykatën Themelore, duke theksuar se e parashtron urgjencën për shkak të nevojës së domosdoshme për shërim mjekësor, për shkak të lëndimeve të pësuar. Parashtruesi i kërkesës theksoi se lënda ka përparësi sepse është në procedurë që nga viti 2000.
93. Lidhur me veprimet procedurale të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së ku kishte sqaruar se parashtruesit të kërkesës i kërkohet të tregojë kujdes në ndërmarrjen e hapave procedural dhe për t'u përmbajtur nga përdorimi i taktikave të vonimit të shqyrtimit të rastit të tij (shih rastet e GJEDNJ-së, *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafi 91 ku GJEDNJ-ja kishte konstatuar se bazuar në sjelljen e ankuesit nuk ka tregues se ai ka shkaktuar apo kontribuar në zvarritje të procedurave; *Union Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35).
94. Në vijim dhe bazuar në veprimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, Gjykata duke vënë theksin në sjelljen e tij, që nga data e parashtrimit të padisë së dytë më 18 prill 2006, konsideron se veprimet e parashtruesit të kërkesës nuk mund të kenë ndikuar në vonesën e Gjykatës Themelore, dhe asaj të Apelit, respektivisht në shqyrtimin e rastit të tij.

(c) *Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore*

95. Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së, *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 64482/09 12874/10 56935/10 3129/12, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91; *Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë*, nr. 33192/07 33194/07, Aktgjykim i 25 qershorit 2013 dhe *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24).
96. Në këtë kontekst, GJEDNJ kishte theksuar se nuk mund të merret në konsideratë arsyetimi i gjykatave për mbingarkesën me lëndë të pazgjidhura (shih rastet e GJEDNJ-së, *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafët 70-71 dhe 94-96; *Krastanov kundër Bullgarisë*, nr. 50222/99, Aktgjykim i 30 shtatorit 2004, paragrafi 74; *Vocaturro kundër Italisë*, nr. 11891/85, Aktgjykim i 1 prillit 1989, paragrafi 17; dhe *Cappello kundër Italisë*, nr. 12783/87, Aktgjykim i 24 janarit 1992, paragrafi 17).
97. Megjithatë, në rastin e GJEDNJ-së, *Buchholz kundër Gjermanisë*, ndaj pretendimit të Qeverisë gjermane se si rezultat i recesionit ekonomik ka pasur rritje të konsiderueshme të vëllimit të proceseve gjyqësore në fushën e punësimit, duke rezultuar në mbingarkesë

me lëndë të pazgjidhura përpara gjykatave, duke përfshirë gjykatat e Hamburgut, GJEDNJ ka sqaruar se: “[...] *Konventa vendos detyrimin për Shtetet Kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që t’u lejojnë gjykatave të përmbushin kërkesat e nenit 6 paragrafit 1 [të KEDNJ-së] duke përfshirë atë të gjyqimit brenda një “afati të arsyeshëm kohor”. Megjithatë, mbingarkesa e përkohshme me lëndë të pazgjidhura nuk i atribuon përgjegjësinë Shteteve Kontraktuese me kusht që ato të kenë ndër marrë veprime të arsyeshme të menjëhershme korrigjuese për t’u marrë me një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji*” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Buchholz kundër Gjermanisë*, nr. 7759/77, Aktgjykim i 6 majit 1981, paragrafi 51).

98. Në vijim të këtij qëndrimi, Gjykata edhe në praktikën e vet gjyqësore ka theksuar se gjykatat e rregullta kanë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor, që çështjet t’i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që të mos shkaktojnë huti dhe pasiguri. Gjykatat e rregullta nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Përndryshe, besimi i publikut ndaj tërë rendit juridik do të minohej (shih në lidhje me këtë arsyetimin e Gjykatës në rastin KI104/20, parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 62).
99. GJEDNJ, poashtu ka përcaktuar që ndërkohë që nuk është funksioni i Gjykatës të analizojë mënyrën në të cilën gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin, megjithatë konsideron se aktgjykimet që anulojnë të gjeturat e mëparshme dhe që rikthejnë çështjen janë zakonisht për shkak të gabimeve të kryera nga gjykatat më të ulëta dhe se përsëritja e gjykimeve të tilla mund të tregojë një mangësi në sistemin e drejtësisë (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 147).
100. Gjykata vëren se në rastin konkret, në procedurën e padisë së dytë ka pasur tri vendime të Gjykatës Themelore, tri vendime të Gjykatës së Apelit, prej të cilave dy kanë qenë të tilla që kanë kthyer çështjen në rigjykim, ndërsa njëra ka vendosur lidhur me rastin, dhe në fund, një vendim i Gjykatës Supreme. Gjithashtu, Gjykata rikujton se Gjykata Komunale në Vushtrri kishte mbajtur një seancë përgatitore me 3 maj 2006, pastaj kishte caktuar një seancë kryesore me 18 maj 2006 por e cila ishte shtyer për 24 maj 2006 dhe ishte mbajtur në po atë ditë. Në procedurën e rigjyqimit të parë Gjykata Themelore mbajti një shqyrtim përgatitor me 23 maj 2013. Në procedurën e rigjyqimit të dytë Gjykata Themelore kishte caktuar një seancë e cila më pas u shty për 12 korrik 2016, dhe në këtë fundit, përmes Aktvendimit u vendos që seanca për shqyrtim kryesor të caktohet për 5 gusht 2016. Gjithashtu, me 31 tetor 2016, u mbajt një seancë dhe me Aktvendim u vendos që (i) seanca shtyhet; dhe (ii) Gjykata Themelore në seancën e radhës do vendosë “*pas vendosjes paraprake për çështjen e parashkrimit të kërkesës*”.
101. Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë kishte mbajtur rreth 5 seanca. Në këto seanca, pretendimet për parashkrim nga ana e palës së paditur ishin ngritur vazhdimisht. Gjykata poashtu vëren se Gjykatës së Apelit i është dashur rreth 6 vite e 8 muaj për të vendosur që çështjen ta kthejë në rigjykim përmes Aktvendimit [CA.nr.452/2012] të 14 marsit 2013. E njëjta ka kthyer çështjen në rigjykim edhe me Aktgjykimin [Ac.nr. 276/17], të 13 qershorit 2019.
102. Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit, ka pasur juridiksion të vendosë lidhur me çështjet faktike dhe juridike, dhe e njëjta ka mundur të vendosë lidhur me rastin. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se përsëritja e gjykimeve të tilla mund tregon një mangësi në sistemin e drejtësisë (shih rastin e Gjykatës KI81/16, parashtrues *Valdet Nikçi*, cituar më lart, paragrafi 71). Zvarritjet e procedurës në rastin e konkret kryesisht iu atribuohen gjykatave të rregullta, sepse atyre iu deshën më shumë se 14 vite për të vendosur një çështje jo të ndërlikuar, pra që të konstatojnë se padia civile e

parashtruesit të kërkesës është parashkruar (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Mesić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 129).

(ç) Rëndësia e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest

103. Lidhur me kriterin e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila sqaron se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet që ndërlidhen me statusin dhe kapacitetin civil, rastet rreth kujdestarisë së fëmijëve dhe marrëdhënies prind-fëmijë, kontestet nga marrëdhënia e punës, rastet e parashtruesve që vuajnë nga “*sëmundje të pashërueshme*” dhe kanë “*pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*”, si dhe rastet rreth të drejtës për arsim (shih rastet e GJEDNJ, *Bock kundër Gjermanisë*, nr. 11118/84, Aktgjykim i 21 shkurtit 1989, paragrafi 49; *Laino kundër Italisë*, nr. 33158/96, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 18, *Mikulić kundër Kroacisë*, i cituar më lart, paragrafi 44; *Hokkanen kundër Finlandës*, nr. 19823/92, Aktgjykim i 23 shtatorit 1994, paragrafi 72; *Niederböster kundër Gjermanisë*, nr. 39547/98, Aktgjykim i 27 majit 2003, paragrafi 39; *Frydlender kundër Francës*, i cituar më lart, paragrafi 45; *Vocaturò kundër Italisë*, i cituar më lart, paragrafi 17; *X kundër Francës*, nr. 18020/91, Aktgjykim i 31 marsit 1992, paragrafi 47; *A. dhe të tjerët kundër Danimarkës*, nr. 20826/92, Aktgjykim i 22 janarit 1996, paragrafët 78-81; *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 15766/03, Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 109 dhe *Sailing Club of Chalkidiki “I Kelyfos” kundër Greqisë*, nr. 6978/18 8547/18, Aktgjykim i 21 nëntorit 2019, paragrafi 60 ku GJEDNJ-ja, mes tjerash, kishte theksuar se mungesa e pajustificuar e një vendimi brenda një periudhe posaçërisht të gjatë nga një gjykatë që e shqyrton çështjen mund të konsiderohet mohim i drejtësisë).
104. Gjykata rikujton që kërkesa e parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me kompensimin e tij për lëndimet e pësuar në vendin e punës. Gjykata në rastin konkret, marrë parasysh që parashtruesi i kërkesës është lënduar në vendin e tij të punës, dhe faktin që sipas shkresave të lëndës për shkak të një lëndimi të tillë, atij iu është dashur të trajtohej jashtë shtetit, dhe iu është dashur të trajtohej në vazhdimësi, konsideron se gjykatat e rregullta do duhej të ishin përgjigjur me kujdes të veçantë lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës.
105. Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta është dashur që në rrethanat e rastit konkret të kenë parasysh respektimin e parimit për administrim të drejtë të drejtësisë, përkatësisht obligimin e këtyre të fundit që të merren siç duhet me rastet para tyre (shih rastin e Gjykatës KI81/16, parashtrues *Valdet Nikçi*, cituar më lart, paragrafi 92).
106. Në këtë drejtim, Gjykata ka mbajtur qëndrim se rastet në gjykatat e rregullta nuk mund të zhvillohen pa ndonjë afat të caktuar për finalizimin e tyre siç ka ndodhur në rastin konkret që procedurat të zgjasin për më shumë se katërmëdhjetë (14) vite për një çështje të drejtpërdrejtë siç është konstatimi i parashkrimit të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, KI81/16, parashtrues *Valdet Nikçi*, cituar më lart, paragrafi 98).

Përfundim lidhur me tejzgjatjen e procedurave

107. Si përfundim, Gjykata konsideron se meqenëse në rastin e parashtruesit të kërkesës gjykatat e rregullta kishin aplikuar dispozitat që rregullojnë parashkrimin, ato si të tilla, nuk kanë qenë aq të ndërlikuara në një masë të tillë që procesi i tërë, nga fillimi i padisë së dytë e deri te vendimi i kontestuar të zgjasë 14 vjet, 7 muaj dhe 8 ditë.

108. Gjykata vlerëson se rasti konkret nuk ka qenë i ndërlikuar sepse (i) gjykatat e rregullta kanë pasur për detyrë që të konstatojnë nëse kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës për kompensim të dëmit është parashkruar ose jo; (ii) dhe se procedura as nuk është ndërlikuar më tej nga veprimet e parashtruesit të kërkesës i cili vetëm sa ka ndjekur hapat procedural për realizimin e të drejtës së tij për kompensim të dëmit që e kishte pësuar në vendin e punës; kurse, (iii) gjykatave të rregullta iu është dashur më shumë 14 vite për të konstatuar me vendim të formës së prerë nëse kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar ose jo. Gjykata rithekson se mos zgjidhja e çështjes së parashtruesit të kërkesës brenda një afati të arsyeshëm përveçse është tejzgjatje e pajustificuar e procedurave gjithashtu mund të konsiderohet mohim i drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Sailing Club of Chalkidiki "I Kelyfos" kundër Greqisë*, cituar më lart, paragrafi 60).
109. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kohëzgjatja e procedurës në tërësi, prej 14 vjet, 7 muaj dhe 8 ditë, në rrethanat e rastit konkret, nuk mund të konsiderohet e arsyeshme.
110. Për pasojë të lartcekurave, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Efektet e këtij Aktgjykimi për parashtruesin e kërkesës

111. Gjykata ka parasysh faktin se procedura për parashtruesin e kërkesës ka zgjatur rreth 20 vjet, e konkretisht në vlerësimin e mësipërm të Gjykatës, prej 14 vjet, 7 muaj dhe 8 ditë, dhe në fund ai ka marrë përgjigje që kërkesa e tij është parashkruar. Në këtë linjë, Gjykata rikujton se ka gjetur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
112. Gjykata vëren dhe konstaton se neni 41 i KEDNJ-së, i cili bën pjesë në Titullin II [Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut] të KEDNJ-së, nuk mund të shërbejë si bazë për të kërkuar "shpërblim të drejtë" apo kompensim për dëm jo-material para Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se ky nen i referohet kompetencave të GJEDNJ-së dhe jo kompetencave të gjykatave vendore pjesë anëtare të mekanizmit mbrojtës të garantuar me KEDNJ. Palët kontraktuese janë të obliguara të garantojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Titullin I [Të Drejtat dhe Liritë] të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, Gjykata e ka parasysh faktin që GJEDNJ akordon "shpërblim të drejtë" apo kompensim për dëm jo-material, mirëpo një gjë të tillë e bën bazuar në kompetencat e saj specifike të përshkruara në nenin 41 të KEDNJ-së dhe rregullin 60 të Rregullores së saj të punës. (shih rastin e Gjykatës, KI108/18 parashtrues *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shtatorit 2019, paragrafi 195).
113. Përkundër faktit që GJEDNJ ka autorizim specifik për të caktuar "shpërblim të drejtë", kjo Gjykatë, është e lidhur dhe e kushtëzuar që të veprojë vetëm në bazë të rregullativës ligjore dhe procedurale që e rregullon punën e saj. Në asnjërin nga dokumentet të cilat e rregullojnë fushëveprimtarinë dhe procedurat para kësaj Gjykate dhe veprimet që kjo e fundit mund të ndërmarrë, nuk parashihet një autorizim ekuivalent për të akorduar "shpërblim të drejtë", ashtu siç një kompetencë e tillë qartazi i përshkruhet GJEDNJ-së me dispozitat e lartcekura. (shih rastin e Gjykatës, KI108/18 parashtrues *Blerta Morina*, cituar më lart, paragrafi 196).
114. Të lartcekurat nuk nënkuptojnë që individët nuk kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre bazuar në ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Përkundrazi, vet GJEDNJ thekson se në mënyrë që një e drejtë e mbrojtur me KEDNJ të riparohet në maksimumin e mundshëm të riparimit, parashtruesit përkatës duhet të dëmshpërblehen dhe atë në lartësinë e duhur dhe në përputhje të drejtë me të drejtën e

cila iu është cenuar. (Shih rastin e Gjykatës, KI108/18 parashtrues *Blerta Morina*, cituar më lart, paragrafi 197 Shih, për shembull, njërin nga rastet e GJEDNJ-së në këtë aspekt: *Gavriliq kundër Moldavisë*, nr. 22741/06, Aktgjykim i 22 korrikut 2014). Megjithatë, ka edhe të tilla raste kur, bazuar në rrethanat specifike të atij rasti, GJEDNJ konsideron se vet gjetja e shkeljes paraqet “shpërblim të drejtë” edhe për dëmin jo-material që një parashtrues mund të ketë pësuar. (Shih në këtë aspekt pjesën operative të rastit të GJEDNJ-së, *Roman Zakharov kundër Rusisë*, nr. 47143/06, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2015, paragrafi 312).

115. Gjykata, më tej sqaron se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji apo mënyre të kompensimit për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave respektive kushtetuese, në rastin konkret nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (1) (shih rastet e Gjykatës, KI10/18, parashtrues *Fahri Deçani*, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, paragrafi 119; KI108/18, parashtruese *Blerta Morina*, cituar më lart, paragrafi 196; si dhe shih rastin, KI113/21 parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafi 148).
116. Megjithatë, dhe për më tepër Gjykata ka theksuar se individët kanë të drejtë të kërkojnë përmes iniciimit të një procedure të ndarë për dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre të bazuara në ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës (shih rastet e Gjykatës KI113/21 parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, cituar më lart, paragrafi 150; KI10/18, parashtrues *Fahri Deçani*, cituar më lart, paragrafi 120; dhe KI108/18, parashtruese *Blerta Morina*, cituar më lart, paragrafi 197).
117. Gjykata vlerëson se vetëm konstatimi i shkeljes për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, nuk përbën “shpërblim të drejtë” për parashtruesin e kërkesës. Prandaj, në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes kushtetuese nga Gjykata mund të mos jetë i mjaftueshëm për të evituar pasojat e shkeljes kushtetuese dhe kur kompensimi monetar është i domosdoshëm, iu takon palëve të përfshira në rast që të shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e mëtejme të të drejtave të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo-material, si rezultat e shkeljeve të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të konstatuara nga Gjykata, duke përfshirë shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI113/21, parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, cituar më lart, paragrafi 151)

Përfundim

118. Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës ishte lënduar në vendin e punës dhe kishte iniciuar padi civile për kompensim të dëmit kundër Ministrisë Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Gjykatën Komunale në Vushtrri. Çështja e parashtruesit të kërkesës kishte përfunduar me Aktvendim [Rev.nr.97/2004] të 25 janarit 2005 të Gjykatës Supreme, që kishte konstatuar se padia civile e parashtruesit të kërkesës është e palejuar për shkak se Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i mungon legjitimiteti pasiv procedural. Parashtruesi i kërkesës paraqiti padinë e dytë në Gjykatën Komunale në Vushtrri e cila e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se është çështje e gjykuar. Gjykata e Apelit, pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, e anuloi aktvendimin e Gjykatës Themelore me arsyetimin se nuk ishin krijuar kushtet që padia e parashtruesit të kërkesës të hedhet poshtë si çështje e gjykuar. Parashtruesi i kërkesës paraqiti padi civile kundër komunës së Vushtrrisë në emër të kompensimit të dëmit. Ndërkohë, Gjykata Themelore në Vushtrri në ri-procedurë e kishte refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës të paafatshme. Gjykata e Apelit, pas ankesës së

parashtruesit të kërkesës, e anuloi aktvendimin e Gjykatës Themelore me arsyetimin se kjo e fundit e kishte ngatërruar institutin e parashkrimit me afatet ligjore. Në procedurë të sërishme, Gjykata Themelore e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se është parashkruar. Në procedurë të ankimimit, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e vërtetuan konstatimin e Gjykatës Themelore se padia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar.

119. Në rastin konkret, Gjykata si çështje paraprake vlerësoi se procedurat e zhvilluara nga viti 2000 deri në vitin 2005 janë jashtë jurisdiksionit kohor të Gjykatës për shkak se janë të papajtueshme *ratione temporis* me Kushtetutën.
120. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për interpretim të gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë, Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
121. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata iu referua kritereve të vendosura nga praktika e GJEDNJ-së por dhe nga vetë praktika e saj që bazohen në: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e palëve në procedurë; (c) sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (ç) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest.
122. Gjykata vlerësoi se rasti konkret nuk ka qenë i ndërlikuar sepse (i) gjykatat e rregullta kanë pasur për detyrë që të konstatojnë nëse kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës për kompensim të dëmit është parashkruar ose jo; (ii) dhe se procedura as nuk është ndërlikuar më tej nga veprimet e parashtruesit të kërkesës i cili vetëm sa ka ndjekur hapat procedural për realizimin e të drejtës së tij për kompensim të dëmit që e kishte pësuar në vendin e punës; kurse, (iii) gjykatave të rregullta iu është dashur më shumë 14 vite për të konstatuar me vendim të formës së prerë nëse kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar ose jo. Gjykata rithekson se mos zgjidhja e çështjes së parashtruesit të kërkesës brenda një afati të arsyeshëm përveçse është tejzgjatje e pajustificuar e procedurave gjithashtu mund të konsiderohet mohim i drejtësisë.
123. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e procedurës prej 14 vjet, 7 muaj dhe 8 ditë, në rrethanat e rastit konkret, nuk mund të konsiderohet e arsyeshme dhe se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.
124. Lidhur me çështjen e kompensimit të dëmit material dhe jo-material të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vlerësoi se vetëm konstatimi i shkeljes të së drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm në vetvete nuk përbën “shpërblim të drejtë” për parashtruesin e kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në procedurë civile pranë gjykatave të rregullta të kërkojë kompensim të dëmit material dhe jo material për shkak të shkeljes së të drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm siç garantohet me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 18 korrik 2022, me shumicë:

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm;
- III. TË KONSTATOJË se nuk ka pasur shkelje tjetër të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [Rev.nr.239/2019] i 26 nëntorit 2020 i Gjykatës Supreme të Kosovës, mbetet në fuqi;
- V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani